

Përmbajtja e Raportit të Monitorimit të Buxhetit të VIII-Mujorit të Bashkisë Fier për Vitin 2023

- A.** Hyrje
- B.** Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi I Raportit të Monitorimit të IV-Mujorit të II-te të Buxhetit 2023
- C.** Permbledhje e Raportit të Realizimeve të Shpenzimeve sipas programeve Buxhetore të Bashkisë Fier
- D.** Realizimi I treguesve të Buxhetit të VI-Mujorit të vitit 2023 sipas programeve buxhetore
 - D.1. Programi I Planifikim Menaxhim Administrim
 - D.2. Programi I Menaxhimit të pyjeve dhe kullotave
 - D.3. Programi I Arsimit baze dhe parashkollor (*kopshte+ndihmes*)
 - D.4. Programi I Arsimit I mesëm I përgjithshëm (*konviktet*)
 - D.5. Programi I Arsimit mbështetës (*Administrata dhe stafit gjithsej në qendër*)
 - D.6. Programi I Zhvillimi I komunitetit (*mbetjet e ngurta*)
 - D.7. Programi I Zhvillimi I komunitetit (*shërbimet publike vendore*)
 - D.8. Programi I Zhvillimi I komunitetit (*shërbimet rurale*)
 - D.9. Programi I Shërbime kulturore
 - D.10. Programi I Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit
 - D.11. Programi I Mbrojtjes nga zjarri
 - D.12. Programi I Mbrojtjes Sociale
 - D.13. Programi I Gjelberimit dhe Mirembajtjes së Varrezave Publike
 - D.14. Programi I rrugëve rurale
- E.** Realizimi I Investimeve të Bashkisë Fier për VIII-Mujorit të Vitit 2023
 - E.1. Realizimi I Investimeve sipas programeve buxhetore .
- F.** Menaxhimi I pronave.
- G.** Realizimi I të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore .
- H.** Auditimi I brendshëm.
- I.** Pasqyrat Përmbledhëse



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER**

Hyrje

Raporti i monitorimit të buxhetit të Bashkisë Fier është një proces vlerësimi i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktike të performancës me ato të planifikuara.

Treguesit kryesorë të Buxhetit të vitit 2023 janë miratuar nga Këshilli I Bashkisë Fier me vendimin Nr. 122 datë 14.12.2022 "Per miratimin e buxhetit Bashkisë Fier të vitit 2023" dhe vendimin nr.17 datë 01.02.2023 "Per shtesën e të ardhurave të trashëguara në Buxhetin e Bashkisë Fier për vitin 2023"

Monitorimi ka për qëllim :

1. Të ndjehet arritjen e qëllimit dhe objektivave të përcaktuara nëpërmjet krahasimit të treguesve të planifikuara të performancës dhe atyre të realizuara.
2. Të sigurojë informacionin i cili shërben për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të zbatimit të buxhetit.

Monitorimi i VIII-Mujorit të vitit 2023 i Bashkisë Fier, është një raport që shpreh me se miri realizimin e qëllimit dhe objektivave në nivel të tetë mujor të programeve buxhetore të kësaj Bashkie . Ai synon të japë një panoramë të qartë të realizimit të treguesve të buxhetit dhe përmbushjen e objektivave të vena për të tetë mujorin e vitit 2023 nëpërmjet administrimit dhe menaxhimit të fondeve publike të 14 programeve buxhetore të saj.

Nëpërmjet këtij raporti është pasqyruar realizimi i investimeve si dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për katër mujorin e dytë të vitit 2023.

Bashkia Fier do të vazhdojë të ofrojë shërbime qytetareve në cilësinë e duhur, me fondet e vena në dispozicion nga pushteti qendror dhe të ardhurat e siguruar nga taksat dhe tarifatat vendore, duke zbatuar me rigorozitet ligjet përkatëse të zbatimit të buxhetit, monitorimit, kontabilitetit dhe ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin me qëllimin final për të zbutur dhe zvogëluar kontrastet midis zonave urbane dhe atyre rurale.

B.Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi I Raportit të Monitorimit të VIII-Mujorit të Buxhetit 2023

Raporti I monitorimit është hartuar në mbështetje:

1. Ligji 139/2015 datë 17.12.2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”,
2. Ligji nr.68 datë 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore “neni 48 pika 1 citohet “Nëpunësit autorizues të njësive të veteqeverisjes vendore I paraqesin këshillit përkatës,sa here që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katër mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve të udhëzimit të Ministrisë të Financave për monitorimin e zbatimit të buxhetit ”.
3. Udhëzimit nr.22 datë. 30.07.2018 “Per procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të veteqeverisjes vendore” paragrafi 48 ,
4. Udhëzimit plotësues nr.2 datë 19.01.2023 “Per zbatimin e buxhetit të vitit 2023” paragrafi 118 cilicton se “Per vitin 2023 nëpunësit autorizues të njësive të veteqeverisjes vendore I paraqesin këshillit përkatës,sa here që kërkohet ,por jo më pak se tre raporte katër mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit,per performance financiare,produktet dhe objektivat e realizuara për çdo program buxhetor të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm”

C. Permbledhje e Raportit të Realizimeve të Shpenzimeve sipas programeve Buxhetore të Bashkisë Fier

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.122 datë 14.12.2022, Per Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2023 “dhe nr.17 datë 01.02.2023 “Per shtesën e të ardhurave të trashëguara të vitit 2023”ligji nr.9936,datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,si dhe ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Per Veteqeverisjen vendore” nga ana e administratës së Bashkisë janë programuar e zbatuar masat për përdorimin në mënyrë të balancuar të të ardhurave të krijuara, me shpenzimet e planifikuara , të realizojë objektivat e synuara ,të produkteve të parashikuara . Gjithsej fonde për 2023 miratuar në Buxhetin fillestar janë **2,212,846** mijë leke ku me vendimin nr. 17 dt. 01.02.2023 fondet e planifikuara për këtë vit u shtuan me **226,668** mijë leke nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2022.

Buxheti total për vitin 2023 ishte 2,439,514 mijë lekë dhe me transfertat e fondeve sektoriale dhe grant të pagushtezuar buxheti total për vitin 2023 është 2,487,044 lekë.

Fondet e planifikuara për tetë mujorin e vitit 2023 janë përdorur në interes të ndërtimit të infrastruktures, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve e trotuareve, rritjes dhe mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelberuara,në pastrimin dhe përpunimin e mbeturinave urbane, në administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike,në ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore e artistike,në zhvillimin e sporteve të ndryshme,në shërbimin social administrativ të çerdheve, kopshteve e shkollave, në mbështetjen dhe nxitjen e biznesit si dhe në zhvillimin urban të qytetit duke **bërë të mundur që të realizojnë objektivat e politikave të çdo programi buxhetor.**

Në total për VIII-Mujorin e vitit 2023 ,raporti i shpenzimeve sipas programeve buxhetore është :

Report Monitorimi i VIII mujorit të vitit 2023

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Kodi i Grupit						
Programe		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
Titulli	Emertimi	Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
		i vitit paraardhes	Plan	Plan Fillestar	Plan i	Plani i	i	
		Viti 2022	Viti 2023	Viti 2023	Rishikuar Viti	Periudhes/progressiv	Periudhes/progressiv	
					2023	Mujori '2023	8- Mujori 2023	
01110	Planifikim menaxhim administrimi	631,434	924,604	924,604	1,004,460	719,811	447,371	-272,440
03280	Mbrojtja nga zjarri	29,325	37,029	37,029	38,145	27,160	22,088	-5,072
04240	Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit	59,027	63,751	63,751	72,739	53,826	35,521	-18,305
04260	Menaxhimi I pyjeve	3,915	4,361	4,361	4,601	3,308	3,992	684
04520	rruget rurale	75	9,462	9,462	9,462	6,655	1,874	-4,781
05100	Zhvillimi I komunitetit (mbetjet urbane)	204,195	218,981	218,981	254,616	191,954	153,530	-38,424
06260	sherbimet publike	221,542	236,131	236,131	308,559	221,730	171,292	-50,438
06260	sherbimet rurale	60,935	66,387	66,387	75,464	40,818	35,410	-5,408
06260	Gjelberimi dhe MVP	93,939	91,916	91,916	106,391	80,492	65,328	-15,164
08220	Sherbimet kulturore	74,013	75,923	75,923	82,448	64,912	61,241	-3,671
09120	Arsimi baze dhe parashkollor (kopshte+ndi)	211,751	217,389	217,389	228,401	163,883	149,035	-14,848
09230	Arsimit i mesem i pergjithshem (konviktet)	30,511	34,047	34,046	34,910	24,810	15,168	-9,642
10430	Arsimit mbeshtetes (Administrata dhe stafi)	134,340	205,826	205,826	239,808	168,201	116,919	-51,282
10430	Mbrojtja sociale	14,917	27,040	27,040	27,040	19,018	10,838	-8,180
shpenzimeve te Ministrise		1,769,919	2,212,847	2,212,846	2,487,044	1,786,578	1,289,607	-496,971
te Ardhurat Jashte limitit								
Totali		1,769,919.0	2,212,847.0	2,212,846.0	2,487,044.0	1,786,578.0	1,289,607.0	

Per tetë mujorin e parë të vitit vitin 2023 është punuar për realizimin e treguesve të buxhetit sipas burimit të krijimit të tyre, artikujve e nenartikujve të strukturës buxhetore të miratuar, si për aparatën e Bashkisë ashtu edhe për institucionet vartëse, por mbi të gjitha të realizojë në nivel të tetë mujor objektivat e buxhetit të vitit 2023 si më poshtë :

- Vazhdimin e përmirësimit të ndjeshëm të infrastrukturës rrugore në qytet dhe sidomos të rrugëve rurale.
- Ofrimi i shërbimeve në çdo Njësi Administrative me qëllimin e përmirësimit të standardit të jetesës së popullatës rurale nëpërmjet zbutjes të kontrasteve midis zonave urbane dhe atyre rurale, duke ofruar përkrahje dhe mbështetje ekonomike në zonat më pak të zhvilluara dhe problematike.
- Vijimin e investimeve për shtimin e hapësirave të gjelbërta, si dhe përmirësimin e shërbimeve të tjera publike, që ndikojnë pozitivisht për një rritje cilësore të jetës në qytet e në zonat rurale.
- Përmirësimin e sistemit të kanalizimeve në të gjithë territorin e Bashkisë Fier në zonat me problematike në vazhdimin për vitin 2023.
- Të nxisë zhvillimin e turizmit nëpërmjet investimeve kapitale në zonat atraktive kulturore historike e fetare dhe në bregdet nëpërmjet projekteve prioritare të miratuara në Dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit.
- Zbatimi i procedurave efektive, për evidentimin e rregjistrimit real për çdo taksapagues, dhe maksimizimin e të ardhurave nga Taksat dhe Tarifatat vendore, duke rritur ndjeshëm ato nëpërmjet shtimit të bazës së taksapaguesve dhe jo nëpërmjet shtimit të vlerës së taksave.
- Përfundimi i investimeve të filluara gjatë vitit 2022.
- Të zgjedhë të kryejë ato shpenzime bazuar në përparësitë dhe prioritetet e komunitetit duke krijuar një ekuilibër të financave të Bashkisë Fier.
- Vlerësimi i nevojave të Komunitetit përmes dialogut publik dhe caktimin e burimeve aty ku është më e nevojshme duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin e ekonomisë.
- Rritja e transparencës si dhe mirepërdorimin e fondeve publike.
- Perthithja e me shumë projekteve prioritare në ndihmë të komunitetit.
- Financimi i projekteve kulturore për gjallërimin e jetës artistike të qytetit.
- Rritja e numrit të aktiviteteve kulturore dhe sportive nga Qendra e Aktiviteteve Kulturore e Bashkisë Fier duke afruar nxenesit e gjithë niveleve parashkollore e parauniversitare.

D. Realizmi I treguesve te Buxhetit te VIII-Mujorit te 2023 sipas programeve buxhetore

- D.1. Programi I Planifikim Menaxhim Administrim
- D.2. Programi I Menaxhimit te pyjeve dhe kullotave
- D.3. Programi I Arsimit baze dhe parashkollor (*kopshte+ndihmes*)
- D.4. Programi I Arsimit I mesem I pergjithshem(*konviktet*)
- D.5 Programi I Arsimit mbeshtetes (*Administrata dhe stafi gjithsej ne cerdhe*)
- D.6 Programi I Zhvillimi I komunitetit (*mbetjet e ngurta*)
- D.7 Programi I Zhvillimi I komunitetit (*sherbimet publike vendore*)
- D.8 Programi I Zhvillimi I komunitetit (*sherbimet rurale*)
- D.9 Programi I Sherbimeve kulturore
- D.10 Programi I Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit
- D.11 Programi I Mbrojtjes nga zjarri
- D.12 Programi I Mbrojtjes Sociale
- D.13 Programi I Gjelberimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike.
- D.14 Programi I Permiresim I Infrastruktures(*rruget rurale*)

• **MENAXHIM PLANIFIKIM ADMINISTRIM.**

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"								
								ne 000/leke
Emri i Grupit	Planifikim ,menaxhim ,administrim						Kodi i Grupit
Programi	01110						Kodi i Programi
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
		i vitit paraardhes Viti 2022	Plan Viti 2023	Plan Fillestar Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Plani i Periudhes/p rogresiv 8-Mujori '23	i Periudhes/pr ogresiv 8-Mujori	
600	Paga	213,198	238,946	238,946	268,739	151,706	141,555	-10,151
601	Sigurime Shoqërore	34,539	39,904	39,904	44,685	27,670	23,463	-4,207
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	210,927	263,579	263,579	231,324	163,216	94,660	-68,556
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja							0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ							0
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	458,664	542,429	542,429	544,748	342,592	259,678	-82,914
230	Kapitale të Patrupëzuara	252						0
231	Kapitale të Trupëzuara	172,518	382,175	382,175	459,712	377,219	187,693	-189,526
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	financim te brendshem	172,770	382,175	382,175	459,712	377,219	187,693	-189,526
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	172,770	382,175	382,175	459,712	377,219	187,693	-189,526
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti	0						
	korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jasht	631,434	924,604	924,604	1,004,460	719,811	447,371	-272,440

Per programin buxhetor menaxhim planifikim e administrim eshte perqendruar puna ne realizimin e objektivave si me poshte :

- Përmirësimi I vazhdueshëm dhe patja e një structure menaxhuese cilësore, për të vënë burimet njerëzore në shërbim të plotë të plotësimit të nevojave të qytetarëve.
- Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interes në proceset vendimarrëse.

Raport Monitorimi i VIII mujorit të vitit 2023

- Hartimi dhe propozimi I ndryshimeve në politikën fiskale, me qëllim mbështetjen e vazhdueshme të rritjes ekonomike të qytetit.
- Të punohet me tatimpaguesit në mënyrë që të likuidojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor, duke siguruar rritjen e te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore që shkojnë për llogari të buxhetit të Bashkisë.
- Shtrirja e sistemit të taksave (TAIS) në të gjitha njësitet administrative për një evidentim sa më të saktë e real të gjithë subjekteve juridike ,fizike dhe taksapaguesve.
- Trajnimi I punonjësve të Bashkisë për të qene sa më eficiente në punë
- Trasparenca publike dhe ofrimi I shërbimit qytetarëve sa më I shpejete dhe eficiente.

Veprimtaria e Zyrës me njendalesë si ofruese e shërbimeve administrative publike të Bashkisë, në kuptimin teorik, është produkti që ofron Bashkia ndaj qytetarëve bazuar në një kërkesë të tyre dhe ky produkt rezulton me përgjigje si vërtetim, licencë, leje, certifikatë autorizimi etj.

Në Zyren me Një Ndalesë funksionojnë 12 sportele të cilët janë përgjegjës për informimin e qytetarëve, administrimin dhe depozitimin e kërkesave, lëvrimin e shërbimit/produktit si rezultat i kërkesës për shërbim dhe administrimin dhe depozitimin e ankesave ndaj shërbimit. Gjatë katër mujorit të vitit 2023 në këtë zyrë janë depozituar dhe administruar kërkesat dhe ankesat nga qytetarët.

Gjithashtu janë perballuar shpenzimet e pageses së personelit të Bashkisë sipas strukture organike të bashkisë të miratuar me urdher të Kryetarit të Bashkisë Nr.393 date 27.07.2023 “Per një ndryshim në urdherin nr.21 date 10.01.2023 “Per miratimin e tabelës së pagave të punonjësve të Bashkisë për vitin 2023”, VKB nr.86 dt 24.07.2023 “Per miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Fier për vitin 2023”, me Vendimin përkatës të Keshillit të Ministrave nr.328,date 31.05.2023 “Per klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të veteqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, Vendimin të Keshillit të Ministrave nr.326,date 31.05.2023 “Per pagat e punonjësve mbeshtetes dhe punonjësve të tjere të specialitetëve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Vendimin të Keshillit të Ministrave nr.113,date 01.03.2023 “Per percaktimin e pages minimale në shkallë vendi”,dhe janë likuiduar detyrimet për derdhjen e kontributit të punedhënesit në masën në zbatim legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

Gjithashtu janë hartuar kontratat për shpenzimet operative dhe një pjesë të investimeve për funksionimin normal të punës në administratë .

Për çdo muaj është dërguar pranë Prefekturës së Qarkut realizimi i treguesve të buxhetit në total si Bashki dhe realizimi i treguesve të buxhetit për funksionet e deleguara, realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore si dhe realizimi i investimeve.

Po kështu gjatë tetë mujorit të vitit 2023 janë përpiluar dhe dërguar pranë Degës së Statistikes së Rrethit evidencat statistikore 8-mujore, mbi numrin e personelit, realizimin e fudit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe investimeve .

Gjatë kësaj periudhe janë derdhur rregullisht detyrimet e percaktuara për sigurimet shoqërore e shëndetësore e tatimin mbi page të personelit në zbatim të Vendimit të Keshillit të Ministrave duke mos krijuar asnjë detyrim të papaguar.

Raport Monitorimi i VIII mujorit të vitit 2023

Po kështu ne perputhje me ligjin dhe dokumentacionin perkates jane shlyer detyrimet ndaj subjekteve te ndryshme private e shteterore per furnizimet dhe sherbimet e kryera, rikonstruksionet e rrugeve si dhe cbllokimin e garancive te punimeve e blerjeve te paisjeve te ndryshme, duke u kujdesur qe Bashkia te mos krijojte detyrime te reja te palikujduara.

Ivestimet e planifikuar dhe te realizuar per kete program jane si me poshte vijon:

Kodi pr+B2:K12ojektit	Emertimi I projektit	Vlera e plotë	Viti i fillimit të	Viti i përfundimit të	Buxheti 2023	Plani i 8 mujorit 2023	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (8-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale
		projektit	projektit	projektit	Kontraktuar				
1110263	Blerje godine Coca Cola	85,000	2020	2023	8,496	8,496	8,496	8,496	26,904
1110124	Shpronetime ,	6,093	2020	2023	7,234	7,234	7,234	7,234	7,234
1110144	Mbikqyrja e objektit: Mirembajtje me sisit vaditje automaikt I siperfaqev	62	2022	2022	62	62	62	62	62
1110322	Blerje pajisje per Drejtorine e Sherbimit te MZSH-se	2,942	2022	2023	2,942	2,942	2,942	2,942	2,942
1110144	Kolaudim punimesh ne objektin:"Ndertim Kuz Libofshe"	238	2021	2022	238	238	238	238	238
1110276	Ndertim Kuz Libofshe	79,014	2021	2022	79,014	29,012	29,012	29,012	50,002
1110144	Kolaudim e objektit: Mirembajtje me sisit vaditje automaikt I siperfaqev	9	2022	2022	9	9	9	9	9
1110228	Blerje malli per Rikonstruksion rrugete te brendeshme trotuare Bashkia Fier	52,310	2022	2023	88,024	88,024	88,024	88,024	88,024
1110323	Blerje mjet tip autovinc me kosh ne lartesi deri me 30 m per MZSH	5,573	2022	2023	5,573	5,573	5,573	5,573	5,573
1110274	Furnizim dhe vendosje parketi profesional sportiv ne Pallatin e Sportit te	9,701	2022	2023	9,701	9,701	9,701	9,701	9,701
1110302	Rehabilitim skema e ujitjes Dega Martin faza II viti 2022		2022	2023			18,031	18,031	18,031
1110144	Kolaudim I punimeve te objektit"Rikonstruksion i arginatures per mbrojtje nga Lumi Vjosa, zona kafaraj-Cerven(bankina e deges se Martines prog.4668. ml prog.6000 ml, L=1332 ml)	135	2022	2023	135	135	135	135	135
1110144	mbrojtje nga Lumi Vjosa, zona kafaraj-Cerven(bankina e deges se Martines prog.4668. ml prog.6000 ml, L=1332 ml)	135	2,022	2023	900	900	900	900	900
1110313	Blerje pajisje sportive per zhvillimin e ndeshjeve sportive ne Pallatin e Sportit te lojerave me dore Viti 2023	9,936	2022	2023	9,936	9,936	9,936	9,936	9,936
1110328	Bashkefinancim I Ndertimit te ambulances Tip A2, Fshati Peshtan, Bashkia Fier	398	2,023	2023	398	398	398	398	398
1110239	Furnizim vendosje panele fotovoltaike me shtylla per ndricim publik	144,428	2,019	2020	12,061	7,000	7,000	7,000	7,000
	Ivestime te tjera ne vazhdim	207,557			234,987	207,557	-	-	
	TOTALI				459,712	377,219	187,693	187,693	227,091

Pra sic po shikohet nga tabela e mesiperm e ivesitimet per kete program eshte realizuar ne masen 38 % por ky realizim vjen sipasose pasi ivesitimet e shumta jane planifikuar nga e trasheguara per kete program.

Le te monitorojme realizimin e treguesve te performances financiare dhe realizimin e politikave te programeve te tjera buxhetore

MENAXHIMI I PYJEVE

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"								ne 000/leke	
Emri i Grupit	Menaxhim I pyjeve							Kodi i Grupit
Programi	04260							Kodi i Programit
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca	
		i vitit paraardhes Viti 2022	Plan Viti 2023	Plan Fillestar Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Plani i Periudhes/pr progresiv 8-Mujori '23	i Periudhes/pr ogresiv 8-Mujori		
600	Paga	3,430.0	3,483.0	3,483.0	3,689.0	2,656.0	3,402.0	746.0	
601	Sigurime Shoqërore	485.0	582.0	582.0	616.0	444.0	590.0	146.0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	0.0	296.0	296.0	296.0	208.0		-208.0	
603	Subvencione							0.0	
604	Transferta Korente të Brendshme							0.0	
605	Transferta Korente të Huaja							0.0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ							0.0	
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	3,915.0	4,361.0	4,361.0	4,601.0	3,308.0	3,992.0	684.0	
230	Kapitale të Patrupëzuara							0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara							0.0	
232	Transferta Kapitale							0.0	
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
230	Kapitale të Patrupëzuara							0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara							0.0	
232	Transferta Kapitale							0.0	
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Totali	Shpenzime Kapitale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
a Të ardhurat jashte limiti		0.0					0.0		
korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jasht		3,915.0	4,361.0	4,361.0	4,601.0	3,308.0	3,992.0	684.0	

Per programin buxhetor menaxhim I pyjeve eshte perqendruar puna ne realizimin e objektivave si me poshte :

- Mbrojtja dhe shendetesimi I siperfaqeve ekzistuese pyjore.
- Hapja e rrugeve Brenda siperfaqeve ekzistuese per te bere te mundur mbrojtjen nga zjarri .
- Nderhyrja ne siperfaqet ekzistuese per ngritjen e pritave dhe pendave malore per mbrojtjen nga erozioni.

Raport Monitorimi i VIII mujorit të vitit 2023

Shpenzimet per paga jane mbeshtetur ne Urdherin e Kryetarit Nr.393 date 27.07.2023 “Per nje ndryshim ne urdherin nr.21 date 10.01.2023 “Per miratimin e tabelës së pagave të punonjësve të Bashkisë për vitin 2023”, VKB nr.86 dt 24.07.2023 “Per miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Fier për vitin 2023”, me Vendimin perkates te Keshillit te Ministrave nr.325,date 31.05.2023 “Per miratimin e struktures se pagave dhe shitesave te tjera mbi pagën e Zevendesministrit ,funktionarve te kabineteve,Prefektit,Nenprefektit,Nenpunesve Civil dhe nenpunes ne disa instucione te administrates publike”,Vendimin perkates te Keshillit te Ministrave nr.328,date 31.05.2023 “Per klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njesive te veteqeverisjes vendore, per efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te punonjësve te organeve te qeverisjes vendore”, Vendimin te Keshillit te Ministrave nr.326,date 31.05.2023 “Per pagat e punonjësve mbeshtetes dhe punonjësve te tjere te specialiteteve te ndryshme ne disa instucione te administrates publike”, Vendimin te Keshillit te Ministrave nr.113,date 01.03.2023 “Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi”, si dhe jane likuiduar detyrimet per derdhjen e kontributit te punedhenesit ne masen me zbatim legjislacionit ne fuqi per sigurimet shoqerore.

- **ARSIMI MBESHTETES (Administrata dhe stafi gjithsej ne cerdhe) 10430**

Raport Monitorimi i VIII mujorit të vitit 2023

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"									
								ne 000/leke	ne 000/leke
Emri i Grupit	Arsimit mbështetes (Administrata dhe stafi gjithsej ne							Kodi i Grupit
Programi	10430							Kodi i Programit
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca	
		i vitit paraardhes Viti 2022	Plan Viti 2023	Plan Fillestar Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Plani i Periudhes/p rogresiv 8-Mujori '23	i Periudhes/pr ogresiv 8-Mujori		
600	Paga	74,586.0	92,545.0	92,545.0	104,526.0	90,647.0	72,262.0	-18,385.0	
601	Sigurime Shoqërore	13,224.0	15,455.0	15,455.0	17,456.0	12,454.0	12,068.0	-386.0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	43,108.0	95,326.0	95,326.0	110,326.0	60,100.0	31,475.0	-28,625.0	
603	Subvencione							0.0	
604	Transferta Korente të Brendshme							0.0	
605	Transferta Korente të Huaja							0.0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ							0.0	
Non-Totali	Shpenzime Korrente	130,918.0	203,326.0	203,326.0	232,308.0	163,201.0	115,805.0	-47,396.0	
230	Kapitale të Patrupëzuara							0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara	3,422.0	2,500.0	2,500.0	7,500.0	5,000.0	1,114.0	-3,886.0	
232	Transferta Kapitale							0.0	
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	3,422.0	2,500.0	2,500.0	7,500.0	5,000.0	1,114.0	-3,886.0	
230	Kapitale të Patrupëzuara							0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara							0.0	
232	Transferta Kapitale							0.0	
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Totali	Shpenzime Kapitale	3,422.0	2,500.0	2,500.0	7,500.0	5,000.0	1,114.0	-3,886.0	
Shpenzime		0.0					0.0		
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		134,340.0	205,826.0	205,826.0	239,808.0	168,201.0	116,919.0	-51,282.0	

Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015,“Për vetëqeverisjen vendore ” është një strukturë e specializuar për të ushtruar kompetencat e parashikuara në pikën 11 dhe 12, të nenit 23, për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale, si dhe administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Politika e këtij programi konsiston në Menaxhimin e financave të Qendrës Ekonomike të Arsimit Fier dhe burimeve njerëzore në përmirësim të ofrimit të shërbimit cilësor të mësimdhënies dhe arritjen e standarteve optimale bashkëkohore ,mësimore për brezat e rinj.

Gjithashtu,në objektivat e institucionit qëndron dhe ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e

ndërtesave arsimore të sistemit parashkollor,arsimit profesional (vetëm konviktet) dhe të çerdheve ,duke krijuar kushte të sigurta sipas legjislacionit në fuqi dhe standarteve europiane.

Per programin buxhetor arsimit parashkollor eshte perqendruar puna ne realizimin e objektivave si me poshte :

- Ofrimi I shërbimit me cilësi në kopshte, cerdhe te qytetit.
- Mbulimi me staf të kualifikuar për çdo instuticion të arsimit bazë dhe parashkollorit në territorin e Bashkisë Fier,duke ofruar shërbim cilësor të mësimdhënies.
- Mundësimi I kushteve të mira të qëndrimit dhe ushqimit në konvikt ,për të gjithë nxënësit e shkollave profesionale të Bashkisë Fier,bazuar në kriterin e largësisë së vendbanimit nga shkolla,me synim arritjen e standarteve optimale bashkëkohore mësimore përbrezat e rinj.
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit parashkollor,arsimit profesional (vetëm konviktet) dhe të çerdheve duke krijuar kushte të sigurta sipas legjislacionit në fuqi dhe standarteve europiane.
- Përbushja e objektivave dhe qëllimeve të Qendrës Ekonomike të Arsimit Fier nëpërmjet rekrutimit cilësor të burimeve njerëzore e mire menaxhimit të burimeve financiare

Gjithashtu jane perballuar shpenzimet e pageses se personelit te arsimit parashkollor sipas struktures organike te Bashkise te miratuar me urdher te Kryetarit te Bashkise Nr.394 date 27.07.2023 “Per nje ndryshim ne urdherin nr.21 date 10.01.2023 “Per miratimin e tabelës se pagave te punonjesve te Ndermarrjeve te Varesise te Bashkise Fier , per vitin 2023 ”, VKB nr.86 dt 24.07.2023 “Per miratimin e nivelit te pagave te punonjesve te Bashkise Fier per vitin 2023”, me Vendimin perkates te Keshillit te Ministrave nr.328,date 31.05.2023 “Per klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njesive te veteqeverisjes vendore, per efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te punonjesve te organeve te qeverisjes vendore”, Vendimin te Keshillit te Ministrave nr.326,date 31.05.2023 “Per pagat e punonjesve mbeshtetes dhe punonjesve te tjere te specialiteteve te ndryshme ne disa instuticione te administrates publike”, Vendimin te Keshillit te Ministrave nr.113,date 01.03.2023 “Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi”,dhe jane likuiduar detyrimet per derdhjen e kontributit te punedhenesit ne masen ne zbatim legjislacionit ne fuqi per sigurimet shoqerore.

Gjatë 8 mujorit te pare te vitit 2023 është synuar konsolidimi financiar dhe administrativ i institucionit me qëllim arritjen plotësisht të realizimit buxhetor dhe treguesve të performancës së përcaktuar në programin buxhetor afatmesëm 2022-2025. Gjithashtu, gjatë 8 mujorit te pare te vitit 2023 është syruar përdorimi me eficiencë dhe efektivitet maksimal i burimeve financiare në raport me rritjen e nivelit të performancës së treguesve .

Këtu janë përfshirë shpenzimet për punonjësit e administratës dhe sektorit mbështetës (sanitare,roje dhe punonjës çerdhe).Gjithashtu janë përfshirë edhe pjesa më e madhe e shpenzimeve për ushqimin,per transportin ,per furnizimin me gaz te lengshem per gatim ,shpenzime per furnizimin me uji te shkollave qytet-njesi,te kopshteve si dhe te cerdheve,si dhe shpenzime per qerat e objekteve te cilat perdoren per qellime kopsht dhe cerdhe femijesh.

Raport Monitorimi i VIII mujorit të vitit 2023

Objektivi i programit është realizuar në masën 49 % pasi shpenzimet më mëdha bëhen për blerje produkte ushqimore, blerje gaz i lëngshëm për gatim, blerje shërbimi për transportin e produkteve ushqimore, dhe për këto blerje janë lidhur kontrata furnizimi në baze të marrëveshjeve kuader me afat 12 mujore, për të cilat edhe shpenzimet do të kryhen sipas furnizimeve të realizuara.

Gjate 8 mujorit të parë të vitit 2023 u planifikua dhe blerja e materialeve të pastrimit dhe dertergjent për nevoja të shkollave, kopshteve, cerdheve dhe konviktit Ferme, e cila është ende në fazë tenderimi dhe pritet lidhja e kontratës brenda muajt Shtator 2023.

Gjate 8 mujorit të parë të vitit 2023 u planifikua dhe kryerje investime, ku vleren më të madhe e zënë investimet për inventar ekonomik, si blerje pajisje për kuzhina, dhe mobilje për kopshte dhe cerdhe, të janë në fazën e përgatitjes së dokumentacionit për fillimin e procedurave të tenderimeve.

Investimet e planifikuara dhe të realizuara për këtë program janë si më poshtë vijon

Projektet me financim të brendshëm (në 000/leke) 8-Mujori 2023							
Kodi pr+B2:K120 jektit		Vlera e plotë	Viti i fillimit	Plani i buxhetit viti 2023	REALIZIMI nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale
	Emertimi I projektit	e projektit	të projektit				
	10430 QEA						
	Shpenz. Instalime tek. Pajisje etj	360		360	-	-	-
1110167	Kondicioner	120	2023	120			
1110167	Pompa uji për shkollat	120	2023	120			
1110167	Pajisje për mbrojtje nga zjarri	120	2023	120			
	Inventar ekonomik	7,140		7,140	1,115	1,115	1,115
1110282	Shpenzime për orëndi zyre	120	2023	120			
1110282	Materiale inventari ekonomik (Mobilje)	600	2023	600			
1110282	Blerje soba për ngrohje me dru	500	2023	500		-	-
	Blerje pajisje për kuzhina	4,600	2023	4,600			
1110282	Materiale inventari ekonomik (Elektroshtëpiake)	1,200	2022	1,200	1,115	1,115	1,115
1110282	Shpenzime për pajisje kompjuterike	120	2023	120			
	Shuma	7,500	-	7,500	1,115	1,115	1,115
	TOTALI	7,500		7,500	1,115	1,115	1,115

- **ARSIMI BAZE PARASHKOLLOR(kopshte +ndihmes) 09120**

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit	Arsimi baze dhe parashkollor (kopshte+ndihmes)						Kodi i Grupit
Programi	09120						Kodi i Programi
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
		i vitit paraardhes Viti 2022	Plan Viti 2023	Plan Fillestar Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Plani i Periudhes/p rogresiv 8-Mujori '23	i Periudhes/pr ogresiv 8-Mujori	
600	Paga	175,180.0	186,280.0	186,280.0	195,717.0	140,427.0	127,292.0	-13,135.0
601	Sigurime Shoqërore	32,297.0	31,109.0	31,109.0	32,684.0	22,906.0	21,257.0	-1,649.0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4,274.0				550.0	486.0	-64.0
603	Subvencione							0.0
604	Transferta Korente të Brendshme							0.0
605	Transferta Korente të Huaja							0.0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ							0.0
Non-Totali	Shpenzime Korrente	211,751.0	217,389.0	217,389.0	228,401.0	163,883.0	149,035.0	-14,848.0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0.0
231	Kapitale të Trupëzuara							0.0
232	Transferta Kapitale							0.0
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0.0
231	Kapitale të Trupëzuara							0.0
232	Transferta Kapitale							0.0
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	Shpenzime Kapitale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
a Të ardhurat jashte limiti		0.0					0.0	
ale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		211,751.0	217,389.0	217,389.0	228,401.0	163,883.0	149,035.0	-14,848.0

Per programin buxhetor te arsimit baze parashkollorit jane pagat e stafit mesimor dhe mbeshtetes ,ku fondet e levruara jane nga transferta specifike .

Puna eshte perqendruar ne realizimin e objektivave me poshte :

- Ofrimi i shërbimit me cilësi në kopshtet e qytetit dhe nësive administrative të Bashkisë Fier.
- Pastrimi ,mirembajtjen dhe ruajtja e godinave ekzistuese me qëllim ofrimin e kushteve sipas standarteve për zhvillimin normal të mesimit .

Raport Monitorimi i VIII mujorit të vitit 2023

Gjithashtu janë perballuar shpenzimet e pageses së personelit (*edukatore*) dhe personeli ndihmes (*sekretaret e shkollave dhe rojet*) sipas strukture organike të bashkise të miratuar me urdher të Kryetarit të Bashkise Nr.394 date 27.07.2023 “Per një ndryshim në urdherin nr.21 date 10.01.2023 “Per miratimin e tabelës së pagave të punonjesve të Ndermarrjeve të Varesise të Bashkise Fier , për vitin 2023 ”, VKB nr.86 dt 24.07.2023 “Per miratimin e nivelit të pagave të punonjesve të Bashkise Fier për vitin 2023”, VKM nr 465 dt 06.07.2022 “Per disa ndryshime në vendimin nr 175 dt 08.03.2017 “Per trajtimin me page të punonjesve mesimore”, VKM nr 241 dt 20.04.2023 “Per disa ndryshime në vendimin nr 175 dt 08.03.2017 “Per trajtimin me page të punonjesve mesimore, Vendimin të Keshillit të Ministrave nr.326,date 31.05.2023 “Per pagat e punonjesve mbeshtetes dhe punonjesve të tjere të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administrates publike”, Vendimin të Keshillit të Ministrave nr.113,date 01.03.2023 “Per percaktimin e pages minimale në shkallë vendi”,si dhe janë likuiduar detyrimet për derdhjen e kontributit të punedhenesit në masen në zbatit të legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqerore.

- **ARSIMI I MESEM I PERGJITHSHEM (konviktet) ,09230**

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit	Arsimit i mesem i pergjithshem(konviktet)						Kodi i Grupit
Programi	09230						Kodi i Programi
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
		i vitit paraardhes Viti 2022	Plan Viti 2023	Plan Fillestar Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Plani i Periudhes/p rogresiv 8-Mujori '23	i Periudhes/pr ogresiv 8-Mujori	
600	Paga	22,290.0	23,741.0	23,740.0	24,481.0	17,438.0	12,593.0	-4,845.0
601	Sigurime Shoqërore	2,794.0	3,965.0	3,965.0	4,088.0	2,912.0	2,103.0	-809.0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5,427.0	6,341.0	6,341.0	6,341.0	4,460.0	472.0	-3,988.0
603	Subvencione							0.0
604	Transferta Korente të Brendshme							0.0
605	Transferta Korente të Huaja							0.0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ							0.0
Ne-Totali	Shpenzime Korrente	30,511.0	34,047.0	34,046.0	34,910.0	24,810.0	15,168.0	-9,642.0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0.0
231	Kapitale të Trupëzuara							0.0
232	Transferta Kapitale							0.0
Ne -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0.0
231	Kapitale të Trupëzuara							0.0
232	Transferta Kapitale							0.0
Ne -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	Shpenzime Kapitale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
a Të ardhurat jashte limiti		0.0					0.0	
ale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		30,511.0	34,047.0	34,046.0	34,910.0	24,810.0	15,168.0	-9,642.0

Këtu janë përfshirë shpenzimet për punonjësit e konviktit dhe shpenzimet për funksionimin e tij.

Objektivi I programit është realizuar në masën 44 %. Shpenzimet më të mëdha bëhen për blerje produkte ushqimore, blerje gaz I lëngshëm për gatim, blerje shërbimi për transportin e produkteve ushqimore, dhe për këto blerje janë lidhur kontrata furnizimi në baze të marrëveshjeve kuader me afat 12 mujore, për të cilat edhe shpenzimet do të kryhen sipas furnizimeve të realizuara.

Gjate 8 mujorit të parë të vitit 2023 u planifikua dhe blerja e materialeve të pastrimit dhe dertergjent për nevoja të shkollave, kopshteve, cerdheve si dhe konviktit Ferme, e cila është ende në fazë tenderimi dhe pritet lidhja e kontratës brenda muajt Shtator 2023.

Për programin buxhetor konviktet, arsimit mbështetës ku fondet e levruara janë nga transferta specifike është përqendruar puna në realizimin e objektivave si më poshtë :

- Ofrimi i shërbimit me cilësi në konviktet e shkollave të mesme.
- Mirembajtjen e godinave ekzistuese për nxitjen e frekuentimit nga nxënësit në shkollat publike.

Gjithashtu janë përballuar shpenzimet e pagesës së personelit të konviktit dhe stafit ndihmes (*sanitaret dhe rojet e arsimit parauniversitar*) sipas strukture organike të bashkisë të miratuar me urdher të Kryetarit të Bashkisë Nr.394 datë 27.07.2023 “Për një ndryshim në urdherin nr.21 datë 10.01.2023 “Për miratimin e tabelës së pagave të punonjësve të Ndermarrjeve të Varesisë të Bashkisë Fier, për vitin 2023”, VKB nr.86 dt 24.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Fier për vitin 2023”, me Vendimin përkatës të Keshillit të Ministrave nr.328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njesive të veteqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, Vendimin të Keshillit të Ministrave nr.326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Vendimin të Keshillit të Ministrave nr.113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pages minimale në shkollë vendi”, dhe janë likuiduar detyrimet për derdhjen e kontributit të punëdhënësit në masën në zbatim legjislativ në fuqi për sigurimet shoqërore.

• ZHVILLIMI I KOMUNITETIT MBETJET URBANE 05100

1. Qëllimi dhe objektivat e programit

Pershkrimi i programit – 05100 “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane”, është Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve nëpërmjet shtimit të sipërfaqes së mbuluara me shërbim pastrim, dizinfektim, dhe grumbullimin i mbetjeve urbane çdo ditë.

Mbështetur në ligjin nr. 8094 datë 21.03.1996 për “Pastrimin e largimin e mbetjeve urbane” me qëllim: Kryerjen e shërbimit të pastrimit në territorin e Bashkisë Fier brenda parametërve të lejuara të standardeve mjedisore.

Politika e këtij programi konsiston në Menaxhimin e financave të Ndermarrjes së Pastrimit Fier dhe burimeve njëzore në përmirësim të ofrimit të shërbimit cilësor të pastrimit dhe largimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Fier.

DETYRAT KRYESORE

Nderrmarja e Pastrim Fier eshte Nderrmarje Publike ne varesi te Bashkise Fier dhe ka per objekt pastrimin , mirembajtjen e higjenezimin e rrugeve, trotuareve e shesheve, pastrim higjenezimin e rrugeve e shesheve neper blloqet e banimit te lagjeve, grumbullimin e transportimin e mbetjeve urbane nga kontenieret e pikat statike dhe depozitimin e tyre ne fushen e mbetjeve urbane , sistemimin, kavalitimin e perpunimin e ketyre mbetjeve, dizifektimin e ambjente publike dhe te institucioneve shtetore social kulturore e arsimore, si dhe krijimin, mirembajtjen e kryerjen e sherbimeve ne siperfaqet e gjelberuara, lulishteve e drureve e shkurreve dekorative ne territorun e Bashkise Fier .

Keto detyra dhe sherbime organizohen , drejtohen e kryhen nga administrate, punonjesit dhe mjetet e mekanizatorete qe perbejne strukturen e kesaj Ndermarrje te miratuar nga Keshilli Bashkiak i Bashkise Fier. Gjithashtu kesaj nderrmarjeje per kryerjen e detyrave i vendoset ne dispozicion buxheti vjetor i cili miratohet ne Keshillin Bashkiak Fier.

Menaxhimi Financiar i Ndermarrjes se Pastrimit Fier është fokusuar në financimin e shpenzimeve për përmbushjen e objektivave prioritare strategjike të mëposhtme:

Objektivi 1.1: Ne kete aktivitet perfshihen shpenzimet per pastrimin e rrugeve, trotuareve, lagjeve, blloqet e banimit dhe ambjenteve te tjera publike, lagje dhe lareje e rrugeve dhe shesheve kryesore

Objektivi 1.2: Ne kete aktivitet perfshihen shpenzimet qe do te kryhen per grumbullimin e mbetjeve ne kontenierte, afer kontenierte,pikave statike te mbetjeve urbane dhe inerte ne Qytet dhe transportimin e tyre per ne piken e grumbullimit te mbetjeve dhe disinfektimi gjate heqjes.Ne kete aktivitet perfshihen dhe shpenzimet qe do te kryhen transportimin e mbetjeve nga pika e grumbullimit per ne icenerator.

Objektivi 1.3: Dizinfektim : Ne kete aktivitet perfshihen shpenzimet qe do te kryhen per dizinfektimin e institucioneve arsimore,istitucionet shendetsore, institucioneve publike rruge, sheshe lulishte, blloqet e shkallet e pallateve me klor e pikes se grumbullimit te mbetjeve ne kontenier,pikat statike, vend-depozitimet,shimblehdhsat,kanalizimet siperfaqesore,tregjet publike etj. Deratizim : Ne kete aktivitet perfshihen shpenzimet qe do te kryhen per deratizimin ne vend-strehimet e bodrumet e pallateve, ne institucionet publike(Azile,spitale,kopshte,shkolla,cerdhe etj). Dezisektim :Ne kete aktivitet perfshihen shpenzimet qe do te kryhen per dezisektimin ne ambjente publike (lulishte,spitale,kopshte azile etj.).

Objektivi 1.4: Ne kete aktivitet perfshihen shpenzimet qe do te kryhen per grumbullimin e mbetjeve ne kontenierte, afer kontenierte,pikave statike te mbetjeve urbane dhe inerte ne Njesite Administrative dhe transportimin e tyre per ne piken e grumbullimit.

Objektivi 1:5: Ne kete aktivitet perfshihen shpenzimet qe do te kryhen per mbarvajtjen e aktivitetit te ndermarjes .

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit	Zhvillimi I komunitetit,mbetjet urbane						Kodi i Grupit
Programi	05100						Kodi i Programi
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
